




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivery	14.05.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHCK	2398/2021		112



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.201/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.201/2021 të datës 29.03.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë: Rr. "Aradha e Shales", Nr.37/H2, Tuneli i Parë në Komunën e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 12.05.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** si e palejuar ankesa me numër A.nr.201/2021 e datës 29.03.2021, e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja, e punësuar në Komunën e Mitrovicës sipas akt emërimit të datës 10.10.2012 në pozitën "Zyrtare e Lartë për Çështje Juridike", me koeficient të pagës 7 (shtatë), më datë 29.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për harmonizimin e pagës nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8). Ankesa e ankueses është pranuar më datë 29.03.2021 dhe është protokolluar me numër Nr. Prot. 1453/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 06.04.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Mitrovicës, ndërsa me datën 20.04.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Mitrovicës, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.201/2021, e datës 29.03.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i ankueses i datës 10.10.2012; Letër rekomandimi për ankuesen i datës 20.02.2017; Formulari për caktimin e objektivave për nëpunësin civil i datës 28.12.2018; Certifikata e ankueses e datës Tetor 2017; Kërkesa për përgjigje e datës 06.04.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 20.04.2021; Përshkrimi i detyrave të punës i ankueses i datës 21.09.2012.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja **është e pa lejuar, sepse:**



Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimin e datës 10.10.2012 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës „ Zyrtare e Lartë për Çështje Juridike” në Komunën e Mitrovicës, me koeficient 7 (shtatë).

Me datë 29.03.2021 ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për ngritje të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8).

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesja lidhur me pretendimin ankimor për ngritje të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8) , nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë udhëheqësit me të lartë administrativ si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje në kuadër të organit të punësimit, kështu që lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim nga udhëheqësi me i larte administrativ në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesja mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.*

Çështja e parashtrimit të ankesës kundër vendimit të organit të punësimit është e përcaktuar edhe me nenin 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, meqenëse ankuesja në këtë procedurë nuk kanë parashtruar fillimisht kërkesë të udhëheqësi me i lartë administrativ i cili konsiderohet punëdhënësi i ankueses, Kolegji vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmëri të ankesës, siç përcaktohet me nenin 129 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.201/2021**

**Hysni MUSTAFA**

*[Signature]*  
**Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

*[Signature]*  
**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së